Vendim nr. 86, datë 01.10.2026

(V- 86/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 01.10.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 50 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ARTUR LIKAJ**

BEHAR LIKAJ, të përfaqësuar nga avokati Eduart Mullaraj, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

MINISTRIA E FINANCAVE, përfaqësuar nga Parashqevi Çabiri, me autorizim.

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokati i shtetit Gramoz Meçani, me autorizim.

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR, në mungesë.

DEGA E THESARIT PUKË, në mungesë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2154, datë 24.05.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-2107, datë 03.06.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 27, 28, 42 dhe 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për**

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve Artur (Edison) Likaj dhe Behar Likaj (*kërkuesit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Financave dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Degës së Thesarit Pukë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 2001 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë ka regjistruar procedimin penal ndaj kërkuesve për kryerjen e veprës penale "Vjedhja me armë", të parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal (*KP*), të kryer në bashkëpunim. Në kuadër të këtij procedimi penal, me vendimin e datës 31.03.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, ndaj kërkuesve është caktuar masa e sigurimit personal "Arresti në burg" dhe në ekzekutim të kësaj mase kërkuesit kanë qëndruar në paraburgim nga dita e arrestimit, 31.03.2001, deri në marrjen formë të prerë të vendimit penal të dënimit të tyre.

2. Në përfundim të gjykimit të çështjes penale ndaj kërkuesve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, me vendimin nr. 64, datë 24.05.2002, ka vendosur t'i deklarojë ata fajtorë për kryerjen e veprave penale "Vjedhja me armë", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 140 dhe 25 të KP-së dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuar nga neni 278 i KP-së, duke i dënuar përkatësisht, me 13 vjet burgim kërkuesin Artur Likaj dhe me 5 vjet burgim kërkuesin Behar Likaj. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 145, datë 09.09.2002, kurse, me vendimin nr. 793, datë 26.12.2002, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve.

Në ekzekutim të vendimit penal të formës së prerë të fajësisë rezulton se kërkuesi Artur Likaj ka qëndruar në paraburgim për 1 vit, 5 muaj e 9 ditë dhe ka vuajtur dënimin me burgim për 7 vjet, 7 muaj e 16 ditë, deri në datën 25.05.2010, kurse kërkuesi Behar Likaj ka qëndruar në paraburgim për 1 vit, 5 muaj e 9 ditë dhe ka vuajtur dënimin me burgim për 1 vit, 7 muaj e 20 ditë, deri në datën 29.04.2004.

3. Në datën 08.03.2004 kërkuesi Artur Likaj ka paraqitur ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)* për shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*). Me vendimin e datës 20.04.2010 në çështjen *Laska dhe Lika kundër Shqipërisë*, GJEDNJ-ja ka konstatuar se në procesin penal ndaj kërkuesit Artur Likaj është cenuar neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së, për shkak se dënimi i tij ishte mbështetur, në thelb, në identifikimin nga dëshmitarët gjatë një procedure njohjeje të zhvilluar në mungesë të avokatit dhe në kushte që orientonin atë identifikim drejt tij (kërkuesit). Sipas GJEDNJ-së, parregullsitë e kësaj procedure, të cilat nuk u korrigjuan gjatë gjykimit, si dhe pamundësia e kërkuesit për të kundërshtuar efektivisht provën materiale mbi të cilën ishte bazuar identifikimi, kanë cenuar në mënyrë të pariparueshme drejtësinë e procesit penal.

4. Mbi bazën e vendimit të GJEDNJ-së të dy kërkuesit kanë paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për rishikimin e vendimeve penale që i kanë deklaruar fajtorë dhe i kanë dënuar ata. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 74, datë 07.03.2012, ka pranuar kërkesën për rishikim, duke prishur vendimet nr. 793, datë 26.12.2002 të po atij kolegji dhe nr. 145, datë 09.09.2002 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe duke e kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Shkodër. Në përfundim të gjykimit të çështjes penale, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 224, datë 17.06.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 64, datë 24.05.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesve, me arsyetimin se nuk provohej fajësia e tyre. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

5. Në vijim, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi me objekt kompensimin për burgim të padrejtë për periudhën e paraburgimit dhe të burgimit. Me vendimin e datës 22.07.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore, duke dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Kjo e fundit, me vendimin nr. 187, datë 10.03.2016, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar të paditurat, Ministrinë e Financave dhe

Degën e Thesarit Pukë, të kompensojnë kërkuesin Artur Likaj në shumën 5.790.000 lekë dhe kërkuesin Behar Likaj në shumën 2.466.000 lekë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim të padituratat, Ministria e Financave, Dega e Thesarit Pukë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2154, datë 24.05.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar pjesërisht padinë dhe duke detyruar të padituratat të kompensojnë për burgim të padrejtë kërkuesin Artur Likaj në shumën 3.600.000 lekë dhe kërkuesin Behar Likaj në shumën 1.384.000 lekë. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs në datën 20.06.2018 kërkuesit, në datën 28.06.2018 Ministria e Financave dhe në datën 03.07.2018 Dega e Thesarit Pukë dhe Avokatura e Shtetit.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-2107, datë 03.06.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura, duke vlerësuar se nuk përmbushen kërkesat e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)* dhe se nuk është as rasti për të vënë në diskutim ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohet kryesisht nga ajo gjykatë.

8. Në datën 22.10.2025 kërkuesit kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese *(Gjykata),* sipas objektit të tij. Ky ankim, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 04.11.2025. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 25.02.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

9. Në datën 30.09.2026 Mbledhja e Gjyqtarëve, në zbatim të neneve 36 dhe 37 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 18 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtari të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, duke e gjetur të bazuar atë.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

10.1. *E drejta për zhdëmtim të drejtë,* e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 5, i KEDNJ-së, pasi, kërkuesit kanë qenë viktima të një gabimi gjyqësor që është korrigjuar vetëm pas ndërhyrjes së GJEDNJ-së. Mosdhënia e një kompensimi të plotë dhe proporcional për periudhën e burgimit të padrejtë përbën shkelje të vazhdueshme, pasi shteti nuk ka përmbushur detyrimin për të riparuar plotësisht dëmin. Kjo shkelje ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta në jetën e kërkuesve, duke përfshirë humbjen e lirisë, izolimin social dhe stigmatizimin shoqëror, dëmtimin e reputacionit, arsye për të cilat kërkuesi Behar Likaj vuan nga depresioni. Ky kërkues ka qenë i mitur në atë kohë, çka e bën ndërhyrjen jo vetëm të paligjshme, por edhe joproporcionale, pasi burgimi ka prodhuar pasoja të rënda dhe afatgjata. Gjykata duhet të vlerësojë pasojat reale që ka sjellë dënimi ndaj tij si i mitur, të marrë në konsideratë përllogaritjen e dëmit të paraqitur nga kërkuesit, konkretisht shumat e kërkuara në padi dhe të orientojë rivendosjen efektive të së drejtës së cenuar.

10.2. *Liria personale*, e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së, pasi kërkuesit janë privuar nga liria për periudha të gjata kohore, duke qëndruar në paraburgim për 520 ditë dhe më pas në burgim për disa vite, ndërkohë që në përfundim të procesit penal janë shpallur të pafajshëm me vendim gjyqësor përfundimtar. Privimi i tyre nga liria ka qenë i pajustifikuar dhe i padrejtë dhe përbën ndërhyrje të rëndë në jetën e individit, duke u shkaktuar dëme reale, morale dhe psikologjike, si dhe pasoja të pariparueshme për integritetin personal dhe reputacionin shoqëror. Moskompensimi i plotë dhe efektiv përbën vazhdim të shkeljes së lirisë personale dhe i ka lënë kërkuesit pa mjet efektiv riparimi.

10.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kërkuesit janë trajtuar në mënyrë të disfavorshme krahasuar me raste të ngjashme, pa u analizuar rrethanat konkrete të vuajtjes së dënimit, dëmi moral e ekonomik.

10.4. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së, në drejtim të *së drejtës së mbrojtjes efektive dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat kanë dhënë një kompensim në masë të reduktuar dhe të pajustifikuar, duke mos marrë parasysh rrethanat konkrete, periudhën e gjatë të privimit nga liria, dëmin moral, social dhe familjar të shkaktuar.

Gjykatat kanë interpretuar në mënyrë formale dhe kufizuese ligjin për kompensimin për privimin e padrejtë nga liria, duke anashkaluar standardet e KEDNJ-së për riparim efektiv dhe të plotë. Kërkuesit janë privuar nga e drejta për të marrë një kompensim real dhe proporcional për dëmin e shkaktuar atyre.

11. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Financave***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

11.1. Pretendimi për cenimin e së *drejtës për zhdëmtim të drejtë* është i pabazuar, pasi gjykata e apelit ka dhënë një vendim të bazuar në ligj e në prova. Kërkuesit nuk kanë arritur të provojnë se në momentin e arrestimit kanë qenë në marrëdhënie pune ose biznesi, pra kanë munguar kushtet e parashikuara në nenin 5, pika 1, të Ligjit nr. 9381, datë 28.04.2005 "Për kompensimin e burgimit të padrejtë" (*ligji nr. 9381*). Gjykata e apelit do të shkelte ligjin nëse do t'i dëmshpërblente kërkuesit me vlerën maksimale, pasi do të barazonte shpërblimin e një individi që është në marrëdhënie pune ose biznesi me një individ që nuk ndodhet në këto kushte. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në bazë të parimeve të së drejtës administrative dhe dispozitave ligjore përkatëse. Shpërblimi nuk ka si qëllim që të marrë përsipër zhdukjen e të gjitha problemeve ekonomike dhe shoqërore të të paraburgosurit, por që të kompensojë dëmin real dhe fitimin e munguar që ka ardhur si pasojë e burgimit të padrejtë.

11.2. Pretendimi për cenimin e *lirisë personale* është i pabazuar, pasi ai ka marrë përgjigje me vendimin e datës 17.06.2013 të Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesve. Gjykatat administrative, të cilat kanë trajtuar kërkesën për kompensim, nuk kanë vënë në dyshim se kërkuesit kanë vuajtur burgim të padrejtë.

11.3. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të *së drejtës së mbrojtjes dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi në thelb ai ka të bëjë me të drejtën e aksesit efektiv, e cila u është garantuar kërkuesve. Çështja është shqyrtuar në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe gjykatat u kanë dhënë përgjigje të argumentuar çështjeve të parashtruara për shqyrtim. Gjykata e apelit, në përputhje me funksionin e saj, ka shqyrtuar vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, duke e vlerësuar interpretimin e saj si të gabuar. Edhe vendimi i

Gjykatës së Lartë paraqitet i plotë, i argumentuar, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje, si dhe në të është arsyetuar çdo përfundim i arritur për çështjen.

12. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

12.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për zhdëmtim të drejtë* i lidhur me *lirinë personale dhe parimin e proporcionalitetit* është i pabazuar, pasi përcaktimi i masës konkrete të kompensimit është në kompetencën e gjykatave të zakonshme dhe gjykata e apelit ka vlerësuar se nuk ekzistojnë rrethana të posaçme që të justifikojnë caktimin e kompensimit maksimal të parashikuar nga ligji. Ky vlerësim gjyqësor i ligjit të zakonshëm nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues. Gjykata e apelit ka zbatuar drejt ligjin, duke respektuar proporcionalitetin dhe kriteret e nenit 5 të ligjit nr. 9381/2005. Kërkuesve u është siguruar aksesi në gjykatë, kanë ushtruar mjetet juridike në dispozicion dhe kanë përfituar kompensim në bazë të ligjit.

12.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* është i pabazuar, pasi kërkuesit nuk kanë parashtruar asnjë argument të nivelit kushtetues që të provojë cenimin e këtij parimi. Ata nuk kanë evidentuar se në cilat çështje të ngjashme Gjykata e Lartë ka vendosur në mënyrë të ndryshme. Megjithatë, gjykatat e zakonshme mund të vendosin ndryshe, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe zbatimit të ligjit është e drejtë e atyre gjykatave, për sa kohë që çdo çështje ka specifikat dhe individualitetin e saj.

12.3. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës së mbrojtjes efektive dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar dhe argumentet e parashtruara janë të pamjaftueshme për të provuar shkeljen e pretenduar. Fakti që kërkuesit nuk janë të kënaqur me shumën e dëmshpërblimit nuk provon se gjykata e apelit nuk ka arsyetuar në mënyrë të drejtë dhe të argumentuar për të drejtën e tyre për dëmshpërblim të drejtë dhe efektiv për burgimin e padrejtë. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë përmbush standardet e procesit të rregullt, pasi tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e rekursit, ligjin e zbatueshëm dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Pretendimi i kërkuesve lidhet me interpretimin dhe zbatimin e ligjit që është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

13. ***Subjektet e interesuara, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Dega e Thesarit Pukë***, ndonëse janë njoftuar rregullisht, nuk kanë paraqitur parashtrime me shkrim përpara Gjykatës.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteret e legjitimimit *ratione personae*, të *shterimit të mjeteve juridike efektive* dhe *ratione temporis* të kërkuesve janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjektet e interesuara nuk kanë ngritur ndonjë prapësim.

16. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar cenimin *e lirisë personale*, *së drejtës për zhdëmtim të drejtë*, *parimit të barazisë përpara ligjit* dhe *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, në aspektet e së drejtës për mbrojtje efektive dhe standardit të arsyetimit të vendimit, të garantuara respektivisht nga nenet 27, 44, 18 dhe 42 të Kushtetutës.

17. Në drejtim të *lirisë personale* kërkuesit kanë pretenduar se privimi nga liria ka qenë i pajustifikuar dhe i padrejtë dhe se moskompensimi i plotë e efektiv përbën vazhdim të shkeljes së lirisë personale, duke i lënë ata pa mjet efektiv riparimi. Sipas subjekteve të interesuara, ky

pretendim ka marrë përgjigje me vendimin e pafajësisë së kërkuesve, ndërkohë që gjykatat administrative që kanë trajtuar kërkesën për kompensim nuk kanë vënë në dyshim se ata kanë vuajtur burgim të padrejtë.

18. Gjykata vëren se me vendim gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Shkodër është vendosur pushimi i çështjes penale në ngarkim të kërkuesve, për shkak se nuk provohej fajësia e tyre. Mbi bazën e këtij vendimi kërkuesit i janë drejtuar gjykatës për të kërkuar kompensimin për periudhën e paraburgimit dhe burgimit të padrejtë. Për rrjedhojë, në procesin gjyqësor të kundërshtuar nuk është vënë në diskutim, në këndvështrim të neneve 27 dhe 28 të Kushtetutës, ligjshmëria e masës kufizuese "Arresti në burg" ose e dënimit me burgim, të dhëna fillimisht ndaj kërkuesve me vendime gjyqësore të formës së prerë, për shkak se ishin akuzuar dhe më pas dënuar për kryerjen e disa veprave penale. Me rigjykimin e çështjes së themelit, kufizimi i lirisë personale nuk përbën më objektin e procesit gjyqësor të kundërshtuar, pasi kërkuesit i janë drejtuar gjykatës për zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ky kufizim, pra për mbrojtjen e një të drejte tjetër kushtetuese, asaj për zhdëmtim të drejtë. Në këto kushte, vetëm fakti se kërkuesit kanë pretendime për masën e shpërblimit të dhënë nga gjykatat dhe mënyrën e interpretimit të ligjit të zbatueshëm, në situatën kur asnjë gjykatë nuk ka vënë në diskutim se ata kanë qëndruar padrejtësisht në paraburgim dhe burgim, nuk mund të konsiderohet se përbën vijim të cenimit të lirisë personale. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e lirisë personale është haptazi i pabazuar, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

19. Në lidhje me pretendimin për *cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit,* kërkuesit kanë parashtruar se në raste të tjera të ngjashme Gjykata e Lartë ka vepruar ndryshe nga çështja e tyre. Në lidhje me këtë pretendim subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se kërkuesit nuk kanë parashtruar asnjë argument në nivel kushtetues që të provojë cenimin e këtij parimi, si dhe nuk kanë evidentuar se cilat janë ato raste të ngjashme në të cilat Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar në mënyrë të ndryshme. Sipas këtij subjekti, mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe zbatimit të ligjit është e drejtë e gjykatave dhe çdo çështje ka specifikat dhe individualitetin e saj.

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të mbështesë *a priori* pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të

ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, në kuptim të këtij standardi, kërkuesit, edhe pse kanë barrën e provës në gjykimin kushtetues, i cili është i natyrës argumentuese, nuk kanë paraqitur prova ose të dhëna për mbajtjen e qasjeve të ndryshme të Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme ose të njëjta me atë të kërkuesve. Në këto kushte edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e *së drejtës për zhdëmtim të drejtë dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor*, në aspektet e *së drejtës për mbrojtje efektive* dhe *standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore*, të garantuara nga nenet 44, 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ato bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Neni 44 i Kushtetutës garanton të drejtën e çdo individi për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim, në përputhje me ligjin, kur është dëmtuar si pasojë e një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore. Megjithatë, ai nuk garanton një shumë të caktuar kompensimi. Ndërsa neni 5, pika 5, i KEDNJ-së parashikon se çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtë për të kërkuar dëmshpërblim. Në rastet e kufizimit të padrejtë të lirisë, kjo garanci konkretizohet në të drejtën për kompensim si mjet për riparimin, në masën më të madhe të mundshme, e pasojave të shkaktuara prej tij (kufizimit). Gjykata, duke theksuar rëndësinë e veçantë që merr liria personale si një e drejtë themelore kushtetuese dhe substanciale, ka vënë theksin edhe në rëndësinë e mundësisë që ka kushdo për të gëzuar të drejtën për kompensim kur kufizimi ka qenë i padrejtë ose kur ai ka tejkaluar afatet e përcaktuara nga ligji (*shih vendimet nr. 70, datë 08.06.2026; nr. 40, datë 17.06.2025; nr. 17, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa më sipër, duke pasur parasysh edhe se në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës liria dhe të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt, Gjykata vëren se pretendimi për cenimin e së drejtës për zhdëmtim të drejtë, bazuar në natyrën dhe thelbin e argumenteve të parashtruara në mbështetje të tij, lidhet me mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë analizuar dhe vlerësuar parashikimet ligjore që rregullojnë kompensimin për burgim të padrejtë në drejtim të masës së dëmshpërblimit të njohur kërkuesve me vendimet gjyqësore të kundërshtuara. Në këto kushte, bazuar në natyrën dhe thelbin e këtij pretendimi, ai do të analizohet

në vijim në drejtim të *së drejtës së aksesit substancial* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

23. Kërkuesit kanë pretenduar se mosdhënia atyre e një kompensimi të plotë dhe proporcional për periudhën e paraburgimit dhe burgimit të padrejtë, si viktima të një gabimi gjyqësor të korrigjuar vetëm pas ndërhyrjes së GJEDNJ-së, përbën shkelje të vazhdueshme të shtetit, i cili ka detyrimin për të riparuar plotësisht dëmin e shkaktuar. Për shkak të veprimeve të organeve shtetërore atyre u kanë ardhur pasoja të drejtpërdrejta që kanë të bëjnë si me humbjen e lirisë, izolimin social, ashtu dhe me stigmatizimin shoqëror, dëmtimin e reputacionit, duke bërë që kërkuesi Behar Likaj, i mitur në kohën e hetimit dhe të gjykimit, të vuajë nga depresioni. Sipas kërkuesve, gjykatat kanë dhënë kompensim në një masë të reduktuar dhe të pajustifikuar, duke mos marrë parasysh rrethanat konkrete të rastit, periudhën e gjatë të privimit nga liria, dëmin moral, social dhe familjar të shkaktuar, si dhe faktin se kërkuesi Behar Likaj ka qenë i mitur në kohën e arrestimit. Gjykatat, vijojnë kërkuesit, kanë interpretuar në mënyrë formale dhe kufizuese Ligjin për Kompensimin, duke anashkaluar standardet e KEDNJ-së për një riparim efektiv dhe të plotë.

24. Subjekti i interesuar, Ministria e Financave, ka prapësuar se gjykata e apelit ka dhënë një vendim të mbështetur në ligj dhe në prova, pasi kërkuesit nuk kanë arritur të provojnë se në momentin e arrestimit kanë qenë në marrëdhënie pune ose biznesi, pra kanë munguar kushtet e parashikuara në nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 9381/2005. Sipas këtij subjekti, shpërblimi nuk ka qëllim të marrë përsipër zhdukjen e të gjitha problemeve ekonomike dhe shoqërore të të burgosurit, por të kompensojë dëmin real dhe fitimin e munguar që ka ardhur si pasojë e burgimit të padrejtë. Po sipas këtij subjekti, gjykatat u kanë dhënë përgjigje të argumentuar çështjeve të parashtruara për shqyrtim dhe vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë paraqitet i plotë, i argumentuar, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje, duke arsyetuar çdo përfundim të arritur prej tij.

25. Subjekti tjetër i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se gjykata e apelit ka arsyetuar në mënyrë të drejtë dhe të argumentuar lidhur me të drejtën e kërkuesve për dëmshpërblim të drejtë dhe efektiv për burgim të padrejtë. Ajo gjykatë ka vlerësuar se nuk ekzistojnë rrethana të posaçme që të justifikojnë caktimin e kompensimit maksimal të parashikuar nga ligji, duke e zbatuar drejt atë dhe duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe kriteret e nenit 5 të ligjit nr. 9381/2005. Po sipas këtij subjekti, kërkuesve u është siguruar aksesi në gjykatë, ata kanë ushtruar mjetet juridike në dispozicion dhe kanë përfituar kompensim në bazë të ligjit të zbatueshëm. Ky subjekt i interesuar ka prapësuar se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përmbush standardin e një gjykimi të drejtë dhe se pretendimet e kërkuesve, për më tepër, lidhen me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, çka është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

26. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit në gjykatë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e së drejtës së aksesit në gjykim. Në rastet kur kërkuesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 1, datë 26.01.2021; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas saj, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme dhe, në mënyrë të veçantë, i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se Gjykata e Lartë, në kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e pretendimeve të natyrës kushtetuese të ngritura në rekurs dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimin nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata rithekson se vetëm një vendim i arsyetuar i jep asaj mundësinë të vlerësojë nëse gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet kryesore të palëve dhe mënyrën se si i kanë trajtuar ato. Veçanërisht kur bëhet fjalë për pretendime me natyrë kushtetuese, mungesa

e arsyetimit të Gjykatës së Lartë e vë në vështirësi ose pamundësi Gjykatën për të vlerësuar nëse ajo i ka marrë në shqyrtim dhe nëse i ka vlerësuar këto pretendime (*shih vendimin nr. 51, datë 20.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve të kërkuesve, pa e shqyrtuar në themel mosmarrëveshjen. Në këtë situatë dhe për të respektuar kufirin midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor, Gjykata për zgjidhjen e çështjes do t'i japë përgjigje pyetjes nëse arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për pretendimet e kërkuesve lidhur me mënyrën e zbatimit të kritereve ligjore për përcaktimin e masës së kompensimit për burgim të padrejtë dhe efektivitetin e së drejtës kushtetuese për zhdëmtim të drejtë. Për këtë qëllim, Gjykata do të ndalet fillimisht në evidentimin e dispozitave ligjore që përcaktojnë masën dhe mënyrën e përfitimit të kompensimit për këtë shkak dhe, më pas, në arsyetimin e vendimmarrjeve dhe mënyrën se si ka disponuar Gjykata e Lartë.

28. Sipas nenit 268 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), personi "*që është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë ka të drejtën e kompensimit për paraburgimin e vuajtur, me përjashtim të rasteve kur është provuar që vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij. E njëjta e drejtë i takon edhe të dënuarit që ka qenë i paraburgosur, kur me vendim të formës së prerë vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa është nxjerrë pa qenë kushtet e parashikuara nga nenet 228 dhe 229"* (*pikat 1 dhe 2*). Sipas nenit 269, pika 2, të KPP-së, masa e kompensimit dhe mënyra e llogaritjes, si dhe rastet e kompensimit për arrestin në shtëpi caktohen me ligj të veçantë.

29. Kërkuesit, pas konstatimit nga GJEDNJ-ja të shkeljes së nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së në procesin gjyqësor penal ndaj tyre, janë rigjykuar nga gjykatat e zakonshme dhe në përfundim të këtij procesi është vendosur pushimi i çështjes penale për shkak se nuk është provuar fajësia e tyre për veprat penale të parashikuara nga nenet 140 e 25 dhe 278 të KP-së. Për këtë shkak, ata i janë drejtuar gjykatës administrative me padi me objekt kompensimin për periudhën e paraburgimit dhe burgimit të padrejtë, nga data 31.03.2001, kur janë arrestuar, deri në datën 25.05.2010 për kërkuesin Artur Likaj, kur është liruar me kusht, bazuar në nenin 64 të KP-së, dhe deri në datën 29.04.2004 për kërkuesin Behar Likaj, kur ka përfunduar vuajtjen e dënimit me burgim. Në padi kërkuesit kanë kërkuar nga të padituratt, Ministria e Financave dhe Dega e Thesarit

Pukë, kompensimin në shumën 10.020.000 lekë për kërkuesin Artur Likaj dhe 3.372.000 lekë për kërkuesin Behar Likaj, duke kërkuar, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 9381/2005, masën 3.000 lekë për çdo ditë privimi nga liria.

30. Me vendimin e datës 10.03.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke detyruar të paditurat të kompensojnë: i) kërkuesin Artur Likaj në shumën 1.560.000 lekë për kohën e paraburgimit (520 ditë) dhe në shumën 4.230.000 lekë për kohën e burgimit (2820 ditë), në total në shumën 5.790.000 lekë; ii) kërkuesin Behar Likaj në shumën 1.560.000 lekë për kohën e paraburgimit (520 ditë) dhe në shumën 906.000 lekë për kohën e burgimit (604 ditë), në total në shumën 2.466.000 lekë. Sipas asaj gjykate, bazuar në parimin *compensatio lucri cum damno*, i takon gjykatës e drejta dhe detyrimi që të rregullojë pasojën që vjen nga kundërligjshmëria e mosveprimit administrativ, në lidhje me detyrimin që ka i padituri, për pagimin e shumës së kompensimit. Në vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, padia është e bazuar në ligj e prova, pasi kërkuesit kanë bërë burgim të padrejtë për periudhën që kanë qëndruar në paraburgim dhe burgim, ndaj duhet të kompensohen, sipas parashikimeve të neneve 2, 3 dhe 5 të ligjit nr. 9381/2005, në masën 3.000 lekë për një ditë paraburgim dhe në masën 1.500 lekë për çdo ditë burgim.

31. Mbi ankimin e të paditurave, Ministrisë së Financave, Degës së Thesarit Pukë dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e datës 24.05.2018, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se masa maksimale e kompensimit prej 3.000 lekësh për një ditë paraburgim dhe 2.000 lekësh për një ditë burgim caktohet kur konstatohet ekzistenca e rrethanave të posaçme të përcaktuara në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9381/2005, të cilat verifikohen dhe analizohen rast pas rasti nga gjykata. Në rastin konkret, sipas gjykatës së apelit, nuk rezultonin të provuara rrethana të tilla, të lidhura kryesisht me gjendjen ekonomike dhe familjare të kërkuesve, të cilat as nuk ishin pretenduar prej tyre. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka vlerësuar se kërkuesit duhej të kompensoheshin në masën 1.500 lekë për çdo ditë paraburgim dhe 1.000 lekë për çdo ditë burgim të vuajtur, duke caktuar kompensimin në shumën 3.600.000 lekë për kërkuesin Artur Likaj dhe 1.384.000 lekë për kërkuesin Behar Likaj.

32. Në vlerësimin e gjykatës së apelit, kërkuesit nuk kanë pretenduar dhe nuk kanë provuar të ardhurat ose fitimet e siguruara prej tyre në periudhën përpara izolimit në kushte paraburgimi e

njëherësh nuk kanë provuar që të kenë realizuar të ardhura në burg. Por, pavarësisht kësaj, kjo gjykatë ka mbajtur në konsideratë faktin se dëmshpërblimi për burgim të padrejtë nuk përbëhet vetëm nga humbja ekonomike që ka pësuar individi ose familja e tij nga burgimi i padrejtë, por edhe nga dëmi që ka pësuar ky individ ose familja e tij nga kjo ngjarje, si dhe rivendosja e të gjitha të drejtave të shkelura ose të mohuara gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu gjykata e apelit ka vlerësuar periudhën e gjatë të qëndrimit të kërkuesve në paraburgim e burgim, veprat e rënda penale për të cilat ata janë akuzuar e që kanë shkaktuar vështirësinë e rivendosjes të të drejtave të shkelura gjatë periudhës së paraburgimit e burgimit. Ajo gjykatë ka gjetur të pabazuar edhe pretendimin për caktimin e masës së kompensimit në bazë të pagës minimale, pasi ndonëse ajo përbën një ndër kriteret dhe rrethanat që merren parasysh nga gjykata në caktimin e masës së kompensimit, nuk mund të përbëjë në vetvete vlerën e kompensimit për burgim të padrejtë dhe, për më tepër, ky pretendim është në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9381/2005.

33. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve të kërkuesve dhe të të paditurave, me arsyetimin se nuk përmbajnë asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Në vlerësimin e atij kolegji, në respekt të standardit konventor dhe kushtetues të procesit të rregullt ligjor dhe nga vlerësimi i rrethanave të mosmarrëveshjes objekt gjykimi të konstatuara nga gjykatat e faktit, në rekurs nuk rezulton të jetë parashtruar asnjë argument i qenësishëm që të lidhet me një nga shkaqet e këtij neni për të cilat mund të ushtrohet e drejta e rekursit dhe nuk është rasti as për të vënë në diskutim ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohet kryesisht nga gjykata.

34. Për sa më sipër, Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, ka lënë të pacenuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila ka evidentuar kriteret ligjore dhe rrethanat konkrete të çështjes, pa arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme se si ato janë vlerësuar në përcaktimin e masës konkrete të kompensimit të dhënë kërkuesve për shkak të burgimit të tyre të padrejtë. Në veçanti, nuk rezulton të jetë vlerësuar në mënyrë të individualizuar rrethana se kërkuesi Behar Likaj, i datëlindjes 13.08.1984, ka qenë i mitur (në momentin e arrestimit, datë 31.03.2001, ai nuk kishte mbushur moshën 17 vjeç) në momentin e arrestimit, si dhe pasojat morale, sociale dhe familjare të burgimit të padrejtë për kërkuesit. Po kështu, gjykata e apelit, duke shqyrtuar pretendimin e palës së paditur për përllogaritjen e kompensimit mbi bazën e pagës minimale, ka vlerësuar se kjo e fundit përbën

një ndër kriteret që merren parasysh në caktimin e kompensimit, por nga arsyetimi i vendimit nuk rezulton se si ky kriter është vlerësuar në rrethanat konkrete të kërkuesve. Gjithashtu, ajo ka marrë në konsideratë periudhën e gjatë të privimit të lirisë dhe rëndësinë e akuzave penale ndaj kërkuesve, ndërkohë që ka vlerësuar se nuk janë provuar rrethana të posaçme që të justifikonin caktimin e kompensimit në maksimumin e parashikuar nga norma ligjore. Megjithatë, nga arsyetimi i vendimit nuk rezulton se si kriteret dhe rrethanat e evidentuara kanë çuar në përcaktimin e masës prej 1.500 lekësh për çdo ditë paraburgim dhe 1.000 lekësh për çdo ditë burgim, duke ulur shumat e caktuara nga gjykata e shkallës së parë.

35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ndonëse ka pasqyruar në vendimin e tij shkaqet e rekursit të kërkuesve, ka vendosur mospranimin e tyre, duke arsyetuar se ato nuk përfshiheshin në ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Megjithatë, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara në rekurs nuk kufizoheshin vetëm në kundërshtimin e masës së kompensimit të caktuar nga Gjykata Administrative e Apelit, por lidheshin me mënyrën e zbatimit të kritereve ligjore për përcaktimin e saj, në raport me rrethanat konkrete të çështjes dhe pasojat e burgimit të padrejtë. Në këtë drejtim, kërkuesit kishin kundërshtuar interpretimin dhe zbatimin e nenit 5 të ligjit nr. 9381/2005, veçanërisht për sa i përket kriterit të pagës minimale, si dhe kishin pretenduar mosvlerësimin e rrethanave të veçanta, përfshirë moshën e mitur të kërkuesit Behar Likaj në momentin e arrestimit, ndërprerjen e shkollimit të tij dhe burgimin e dy pjesëtarëve të së njëjtës familje. Po kështu, ajo gjykatë nuk ka analizuar as në lidhje me faktin se për kërkuesin Behar Likaj, gjykata e apelit ka vlerësuar se ai nuk kishte provuar të ardhurat nga puna për periudhën përpara burgimit, pa marrë në konsideratë se në atë kohë ishte i mitur dhe nxënës shkolle.

36. Këto pretendime, për nga natyra dhe përmbajtja e tyre, lidheshin me efektivitetin e së drejtës për zhdëmtim të drejtë, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës dhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për këtë arsye, Gjykata e Lartë kishte hapësirë për t'i shqyrtuar ato në drejtim të respektimit të standardeve kushtetuese dhe për të vlerësuar nëse gjykata e apelit kishte dhënë një arsyetim të mjaftueshëm për mënyrën e zbatimit të kritereve ligjore të kompensimit. Megjithatë, nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk rezulton që pretendimet e mësipërme të jenë marrë në shqyrtim dhe të kenë marrë një përgjigje të arsyetuar. Në këto kushte, Gjykata çmon se mospranimi i rekursit, duke u mjaftuar me parashtrimin e

shkaqeve të tyre dhe me konstatimin e përgjithshëm se ato nuk janë nga shkaqet e parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese, nuk ka garantuar të drejtën e kërkuesve për akses substancial në gjykatë, të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

37. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, duke sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës për zhdëmtim të drejtë, sipas arsyetimit të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-2107, datë 03.06.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 01.10.2026

Shpallur më 09.11.2026